



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 20 korrik 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selvije Halimi, Kolë Berisha dhe Radmila Vujović,

Munguan: Gani Geci, Adem Hajdaraj dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Isuf Zejna – KDI, Lumnije Murati – ZPRK, Dafina Bardhi dhe Albulena Ademi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 7 dhe të 9 korrikut 2010,
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në P/L për produktet dhe pajisjet medicinale, nr-03/ L-188,
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 7 dhe të 9 korrikut 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 7 dhe 9 korrik 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në P/L për produktet dhe pajisjet medicinale, nr-03/ L-188

Kryetari – I paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në P/L për produktet dhe pajisjet medicinale. Pati vërejtje në amendamentet 24, 27 dhe 63. Propozoi që në raportin e dërguar Komisionit FunkSIONAL të përfshihen vërejtjet në këto amendamente.

Meqë nuk pati vërejtje të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i shqyrtoi propozimamendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe konstatoi se Projektligji me amendamente i Komisionit FunkSIONAL ka bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamenteve 24, 27 dhe 63.2, për të cilat i paraqiti vërejtjet si në vijim:

- Amendamenti 24 është në kundërshtim me Ligjin për shërbimin civil, si dhe në kundërshtim me përgjegjësitë e Komisionit FunkSIONAL të Kuvendit.
- Amendamenti 27 është i paqartë, sepse Ligji për shërbimin civil i njeh dy komisione: Komisionin Disiplinor dhe Komisionin e Ankesave, kurse nuk e parasheh Komisionin e Etikës, ngase kjo çështje rregullohet me rregulla të brendshme të institucionit.
- Amendamenti 63, pika 2, është i panevojshëm, sepse çështja e afateve për zgjedhjen e drejtorit rregullohet me akte nënligjore për zgjedhjen e shërbyesve civilë.

2. Komisioni sugjeroi që vërejtjet të shqyrtohen në mbledhjen e radhës të Komisionit FunkSIONAL dhe pas shqyrtimit, Projektligji me amendamentet e propozuara të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në një nga mbledhjet plenare me vërejtjet e Komisionit.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare

Kryetari – I paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare. Pati vërejtje në amendamentin 23, sepse vepra penale e shpërdorimit të detyrës zyrtare është e përcaktuar me Kodin penal të Kosovës.

Meqë nuk pati vërejtje të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Rekomandim

- 1. Komisioni sugjeron që amendamenti 23 të hiqet, sepse vepra penale e shpërdorimit të detyrës zyrtare është e përcaktuar në nenin 339 të Kodit penal të Kosovës.*
- 2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në seancën plenare të Kuvendit, me vërejtjen e Komisionit.*

5. Të ndryshme.

Kryetari - I njoftoi anëtarët se komisionet kryesore i kanë shqyrtuar propozimamendamentet e Komisionit FunkSIONAL në P/L për gjykatat dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje përkitazi me vlerësimet e ndikimeve buxhetore, të të drejtave të njeriut, të të drejtave të komuniteteve dhe të përputhshmërisë me *Acquis Communautaire*. Për këtë kërkoi deklarinimin e anëtarëve që P/L të procedohet tutje.

Komisioni vendosi ta procedojë për shqyrtim dhe për miratim në një nga mbledhjet plenare të Kuvendit P/L për gjykatat me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni